



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:264075
Datë: 04.10.2021
Numri i dokumentit: 02575140

C.nr.1006/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Venhar Salihu, me bashkëpuntorin profesionale Faton Lakna, në çështjen kontestimore të paditëses G... S- nga Gjilani, Rr. të cilën e përfaqëson me autorizim avokat, kundër të paditues Kompania e Sigurimit "...", me seli në Prishtinë, Rr."Tringë Smajli", të cilën e përfaqëson me autorizim Veton Bublaku nga Prishtina, me objekt kontesti, kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 2,936.00€,¹ pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të dt. 13.09.2021, jashtë seancës me dt. 23.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses -Limoni nga Gjilani, **DETYROHET** e paditura, Kompania e Sigurimit "" nga Prishtina, që paditëses t'ia paguaj shumën prej 2,011.00€ në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial edhe atë për dëmin jomaterial: shumen prej 950€ për dhembje fizike; shumen prej 850€ për përjetim të frikës; shumen prej 200€ për përkujdesje dhe ndihmë të huaj, kurse për dëmin material shumen prej 11€ për shpenzimet e mjekut. Të gjitha këto me kamat ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtëj shumës së gjykuar (aprovuar), për kompensimin e dëmit jomaterial në lartësi prej 925.00 € edhe atë: shuma prej 150€ për dhembje fizike; shuma prej 250€ për përjetim të frikës; shuma prej 155€ për përkujdesje dhe ndihmë të huaj; dhe shuma prej 370€ për ushqim të përforcuar .

III. OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimit "..., që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 717.40€, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

Arsyetimi

Paditësja nga Gjilani përmes përfaqësuesit të sajë av., në këtë gjykatë me datë 13.11.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimit "" me seli në prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi të përgjithshme prej 2,936.00 €, për shkak të dëmit material dhe jomaterial të pësuar në aksidentin e komunikacionit të ndodhur më

¹ Fillimisht paditësja në padinë e sajë vlerën e objektit të kontestit e ka paraqitur 4,801.00 €, mirëpo në spjegimet përfundimtare ka hequr dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë, ku vlera e objektit të kontestit është si në pjesën hyrëse të aktgjykimit.

dt.02.09.2019, nga ana e të sigurvearit të paditurës, me kamat ligjore prej 8%, te gjitho këto në afat prej 15 ditësh duke filluar nga dita e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën pasojat e përmbarimit te dhunshëm ligor.

Perfaqësuesi i të paditurës në përgjigjeje në padi të dt.16.12.2019, e konteston kërkespandinë e paditëses për kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial vetëm për nga lartësia e kërkesës, duke theksuar se e paditura në procedurën e rregullt e ka trajtuar kërkesën e paditëses për kompenzim demi ku në baze të provave dhe dokumentacionit mjekësorë të prezantuar të datës së aksidentit, kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore pa pasoja të përhershme tek paditësja.

I autorizuari i paditëses në seancën përgatitore, kryesore, e po ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pran padisë dhe ndryshimeve të kërkespadiës, duke kërkuar nga gjykata që e njejta të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave prej 2,936.00 €, në emër të dëmit material dhe jomaterial, me kamat ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, gjithashtu i njejti ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 717.40 €, edhe atë shumën prej 104 € për përpilimin e padisë, 270.40 € për dy seanca të mbajtura, 302 € për dy ekspertiza mjeksore, dhe 41 € për taksën gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit te dhunshëm ligor.

I autorizuari i të paditurës, në seancën përgatitore, kryesore dhe në spjegimet përfundimtare thekson se nuk e kundërshtojmë bazën juridike të kërkespadiës, por e kontestojmë lartësinë e kërkespadiës, dhe gjithashtu kërkon nga gjykata që shumën e precizuara nga ana e përfaqësuesit të paditëses ti refuzoj si të pabazuara kurse ta aprovoj shumën prej 1,000.00 €, nga se mendojmë se kjo shumë është reale për lëndimet të cilat i ka pësuar paditësja në aksidentin në fjale. Sa i përket kamatës i njejti kërkon nga gjykata që e njejta të aplikohet nga dita e nxjerrjes së aktgjyqimit, e jo nga dita e paraqijes së padisë siq kërkon përfaqësuesi i paditëses.

Gjykata në seancën përgatitore të dt.24.03.2021, ka konstatuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese faktet se aksidenti ka ndodhur me dt.02.09.2019, që në këtë aksident ka pësuar lëndime trupore paditësja G..., e njejta ka kërkuar ndihmë mjeksore në Spitalin e gjilanit, se policia ka përpiluar raport për këtë aksident, e gjithashtu për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese as dëmi material sa i përket shpenzimeve të mjekut në shumë prej 11 €, por për palët ndërgjyqëse mbeten kontestuese faktet lidhur me lëndimet e paditëses, dhe lartësia e kërkespadiës.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje civilo-juridike, gjykata në seancën e dt.13.09.2021, bëri administrimin e këtyre provave edhe atë: Eekspertizën psikiatrike të punuar nga Dr.; Ekspertiza ortopedike të punuar nga Dr. Raportin Policor të dt.02.09.2019; Raportin e Spitalit të Përgjithshëm të dt.02.09.2019, dhe 09.09.2019; 4 dëftesa për pagesë të dt.07.09.2019, 02.09.2019, 09.09.2019, dhe 11.09.2019; dhe një rentgen.

Pas vlerësimit të provave të administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. gjykata vërtetoi faktin rreth natyrës së lëndimeve se paditësja në këtë aksident ka pësuar dëmtime emocionale/psikologjike me efekte: Frikë primare me intensitet shumë të lartë 2-3 sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë rreth 20 minuta, frikë sekondare me intensitet mesatar rreth 20 minuta, frikë sekondare me intensitet të ulët rreth 10 ditë.

Nga ekspertiza e ekspertit të ortopedisë Dr. gjykata poashtu vërtetoi faktin rreth natyrës së lëndimeve se paditësja në këtë aksident ka pësuar lëndime të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore si: Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë prej 30 minuta, dhembje të intensitetit të lartë 2 orë, dhimbje të intensitetit të mesëm 3 javë, dhembje të intensitetit të lehtë 6 javë, duke theksuar se e njëjta ka pasur nevojë për përkujdesje të personit të tretë për një periudhë prej 1 jave, dhe terapi fizikale dhe rehabilitim 1 x 15 ditë, vitin e parë pas aksidentit. Kurse në anën tjetër eksperti në ekspertizën e tijë konstaton se shëmtim trupor nuk ekziston, nuk ekziston as zvogëlim i aktivitetit të përhershëm jetësorë, e gjithashtu nuk ka qenë i nevojshëm as ushqimi i përforcuar.

Gjykata ekspertit të psikiatrisë Dr., dhe ekspertit të ortopedisë Dr. ia falë besimin e plot, për faktin se ekspertizat e tyre ishin të qarta rreth natyrës dhe shkallës së lëndimeve, gjithashtu ishin të punuara në mënyrë profesionale, ku përfaqësuesi i të paditurës nuk ka pasur vërejtje ndërsa përfaqësuesi i paditëses ka pasur vërejtje në ekspertizën ortopedike por i njëjti nuk ka propozuar që të nxjerrët ndonjë ekspertizë tjetër.

Gjykata administroi edhe prova tjera por të njëjtat nuk i arsyetoj veç e veç pasi që ato nuk do të ndikonin në gjendjen faktike apo në marrjen e ndonjë vendimi tjetër siç është vendosur.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë, përkatësisht duke vërtetuar faktin se paditësja në aksidentin e dt.02.09.2019 ka pësuar lëndime të lehta trupore, dëmtime emocionale/psikologjike me frikë primare të intensitetit shumë të lartë, frikë sekondare të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, e po ashtu ka pasur edhe dhimbje fizike të intensitetit shumë të lartë, të lartë, të mesëm, dhe intensitetit të ulët, në njërin anë kurse në anën tjetër duke u bazuar në dispozitat ligjore 136.1, 137, 140, 179 dhe 183 pika 1 dhe 2 dhe 184 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve lidhur me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësisë, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara për dëmin jo material, për paditësen Ganimete Salihi-Limoni gjykata gjykoi shumë prej 2,000.00 €, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe atë duke u bazuar në nenin 323 të LPK-ës, pasi që në rastin konkret baza juridike nuk është kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadisë e në pamundësi për ta përcaktuar në mënyrë të saktë shumat për dëmin jo material, gjyqtari i çështjes vendosi sipas çmuarje së lirë, bazuar në praktikat gjyqësore në raste të ngjashëm dhe duke u bazuar në ekspertizat e ekspertëve mjekësor të psikiatrisë Dr. Ramadan Halimi, dhe të ortopedisë Dr. Rinor Velekinca, ku të njëjtit siç shpjeguar në gjendjen faktike si më lartë, kanë vërtetuar se paditëses me rastin e aksidentit i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe

dëmtime emocionale e psikologjike. Prandaj, shuma e gjykuar për kompensimin e dëmit jo material si më lartë, është më shumë një lloj satisfaksioni moral për paditësen meqë është e ditur se çfarëdo shume e aprovuar, përsëri nuk do të ishte e mjaftueshme me peshën e lëndimeve dhe dëmtimeve emocionale e psikologjike të pësuar në aksidentin në fjalë dhe për këto arsye kjo gjykatë mendon se shumat e gjykuara (si në pikën I), janë shuma të arsyeshme dhe sadopak do të mund të ndikojnë në zbutjen e dhimbjes të paditëses.

Sa i përket shumës prej 11.00 €, në emër të dëmit material, këtë shumë e aprovoi gjykata, pasi që e paditura nuk e ka kontestuar këtë shumë të kërkuar nga ana e paditëses.

Sa i përket kamatës, gjykata u bazua në nenin 382 pika 1 dhe 2 të LMD-së, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj kamatën nga data e dorëzimit të padisë siç ka kërkuar e njëjta me padi e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që të refuzoj vlerën e kërkuar përtej shumës së gjykuar (aprovuar) prej 1,140.00 €, për kompensimin e dëmit jo material dhe atë për dhimbjeve fizike shumë prej 150€, për përjetim të frikës shumë prej 250€, për përkujdesje dhe ndihmë të huaj shumë prej 155€, dhe për ushqim të përforcuar shumë prej 370€, pasi që në rastin konkret shumat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit për dëmin jo material për shkak dhimbjeve fizike, frikës, për përkujdesje dhe ndihmë të huaj janë shuma reale dhe janë satisfaksion moral për paditësin, kurse sa i përket kërkesës për ushqim të përforcuar gjykata refuzoi këtë kërkesë duke u bazuar në nenin 322, pika 1 dhe 2 të LPK-së, pasi që paditësja këto fakte nuk i ka vëretuar me asnjë provë të vetme dhe nuk ka ofruar asnjë faturë që ka konsumuar ushqim të përforcuar, kurse në anën tjetër se nuk ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar kjo u vërtetua edhe me ekspertizën e ekspertit të ortopedisë Dr.Rinor Velekinca ku në pikën V të kësaj ekspertizë thekson se “Ushqimi nuk ka qenë i nevojshëm të jetë i pasur me vitamina, proteina, dhe minerale”, prandaj edhe u reuzua.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, pasi që e paditura ka humbur këtë rast dhe për këtë arsye e detyroi të njëjtën që paditëses ti paguaj shpenzimet e kësaj procedure edhe atë: shumë prej 104€ për përpilimin e padisë, shumë prej 270.40 €, për dy seanca të mbajtura, shumë prej 41 € për taksën për padi, si dhe shumë prej 302 €, për shpenzimet e ekspertizave mjekësore.

Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar në nenin 2, dhe nenit 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1006/19, dt. 23.09.2021

Gjyqtari,
Venhar Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.